



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
KABINETI

Nr 1001 Prot

Tiranë, më 12.02. 2014

URDHËR

Nr 50 Datë 12.02.2014

PËR

”INVENTARIZIMIN E PAJISJEVE MJEKËSORE”

Në zbatim të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës së Shqipërisë dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 864 datë 04.12.2012 të Rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve mjekësore”, pika 14, *Sistemi i Informacionit të Pajisjeve Mjekësore*:

URDHËROJ:

1. Të gjithë institucionet shëndetësore publike të bëjnë inventarin e pajisjeve mjekësore dhe ta dërgojnë tek Qendra Kombëtare Inxhinierisë Bio-Mjekësore sipas formatit, metodologjisë dhe afateve të përcaktuara në planin e veprimit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Procesi i regjistrimit fizik (plotësimi i formularëve për pajisjet) nga institucionet shëndetësore dhe dërgimi tek Qendra Kombëtare e Inxhinierisë Bio-Mjekësore të përfundojë brenda datës 28.03.2014.
3. Hedhja e informacionit në Sistemin online të Informacionit CLINGO të përfundojë brenda datës 31.05.2014.
4. Të gjithë institucionet shëndetësore të raportojnë në mënyrë të vazhdueshme çdo ndryshim të gjendjes së inventarit (prurje ose nxjerrje jashtë përdorimi) sipas standardeve të vendosura nga Qendra Kombëtare e Inxhinierisë Bio-Mjekësore.
5. Ngarkohet Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe e Sistemeve Mjekësore për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

